V E N D I M
Nr. 212, datë 16.5.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 38, DATË 25.1.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË "SUPERFOSFATIT" SH.A KURBIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 38, datë 25.1.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate.".

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

"5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko